

Konform nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, nenit 12 alinea 1 dhe 2 dhe të nenit 17 alinea 1, pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nenit 25 alinea 4, pika (b) dhe të nenit 27 alinea 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor 2009, miratoi këtë

**V E N D I M**  
**MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË PLANIT**  
**ZHVILLIMOR URBAN (PLANIT TË PËRGJITHSHËM URBANISTIK) TË**  
**QYTETIT TË PRIZRENIT**

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit të Asamblesë Komonale për miratimin e Planit Zhvillimor Urban (Planit të Përgjithshëm Urbanistik) të Qytetit të Prizrenit nr. 01/011-47 të dt. 16.09.2004.

Neni 2

Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit të Planit Zhvillimor Urban (Planit të Përgjithshëm Urbanistik) të Qytetit të Prizrenit, bëhet sa i përket etazhitet i cili nga P+5 deri në P+7 (sa është paraparë me PZHU) duhet të rritet- ashtu që:

- Për lokacionin përball „Qendrës Sportive „Bazhadarhana-2„, deri në P+20
- Ndërsa për lokacionet tjera varësisht prej koeficientit të ndërtimit.

Neni 3.

Në pjesën tjetër Vendimi i Planit Zhvillimor Urban (Planit të Përgjithshëm Urbanistik) të Qytetit të Prizrenit, nr. 01/011-47 të dt. 16.09.2004 mbetet i pandryshueshëm .

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër si dhe Drejtoria për çështje pronëso-ro-juridike.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe i njëjti do të shpallet në “Kumtar”.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT**

Nr. 01/011-4320

Më 18 qershor 2009



Kryesuesi i Kuvendit  
Njazi Kryeziu